

**AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE**  
**ME PEGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“Den - Led”**

**NENI 1**

Shoqeria Private “Den - Led” formohet nga themeluesi : Agim Arapi ,I biri I Ganiut, me dtl. 15.10.1960,lindur ne Bicakaj Lushnje e banues ne Lagjen “Xhevdet Nepravishta” Lushnje.

**NENI 2**

Selia e shoqerise eshte në Lagjen “ Xhevdet Nepravishta” Nr.11 Lushnje.  
Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj me zgjerimin e aktivitetit me miratimin e ortakut te vetëm.

**NENI 3**

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:

Per zbatim :

- Kat. 1 - punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh
- Kat. 2 - a,c
- Kat. 3 - a,b ndertime civile e ekonomike
- Kat. 4/ a - ndertim rruge kat. V, IV
- Kat. 6/ a - ndertim vepra arti te vogla deri 6 metra
- Kat. 8/ a - ndertime diga, galeri, tunele, damba etj.
  - b - ndertim ujesejellesa e kanalizime.
  - c - ndertime vepra kullimi, ujitje toke e impiante vaditese.
  - g - punime mbrojtje dhe sistemi hidraulik.
- Kat. 9/ c - themele te vecanta.
  - d - perforcim themeli dhe punime speciale nentokesore.
  - e - izolim themeli nga ujrat.
- Kat.10/a - rindostrucione godina civile, ekonomike, veshje fasadash etj.
- Kat.14/d - mirembajta dhe zhvillimi I dekorit ne mjediset urbane
  - b - pastrimi I siperfaqes urbane.

**NENI 4**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj me afat mbi 10 vjet te marre si vite kalendarike duke filluar nga data e regjistrimit ne regjistrin tregetar.

**NENI 5**



Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke.  
Ky kapital eshte teresisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetem .  
Shoqeria mund te shtoje ose pakesoje kapitalin e saj me miratimin e ortakut themelues .

### NENI 6

Organi me i larte i drejtimit te shoqerise eshte ortaku i vetem, organi vendimor.  
Shoqeria mund te administrohet:

- Nje administrator unik i vetem, aktualisht Z.Agim Arapi, me drejtues teknik Z.Dhimiter Koli Lako, me dtl. 1952, banues ne lagjen "Gafurr Muco Lushnje.
- Nje keshill administrativ.
- Dy administratore me nje firme te perbashket ose te vecante per secilin.

### NENI 7


Shtimi i ortakeve:

- Kur ortaku i vetem eshte dakort, qe te behen shtesa kapitali me ane te personave te tjere qe keta te konsiderohen ortake duhet te veprohet keshtu :

- Se pari merret vendim nga ortaku i vetem, ku shqyrtohet kerkesa e te interesuarit, behet pranimi dhe percaktohet kuota e kapitalit qe do te derdhe ortaku i ardhshem.

- Se dyti behet regjistrimi ne librin e ortakut, ku shkruhet emri i plote i ortakut te ri dhe kuota ne kapitalin social.

- Veprimi i bashkimit te ortakut te ri duhet te behet me nje akt noterial.



**THEMELUESI I SHOQERISE**

AGIM ARAPI



# STATUTI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"Den - Led"

### FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA

#### NENI 1

Shoqeria private "Den - Led" formohet nga themeluesi Agim Arapi, I biri I Ganiut me dtl. 15.10.1960, lindur ne Bicakaj Lushnje e banues ne lagjen " Xhevdet Nepravishta " Lushnje.

#### NENI 2

Shoqeria eshte person juridik, dhe eshte krijuar ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe si e tille e fillon aktivitetin me regjistrimin e saj ne regjistrin tregetar.

#### NENI 3

Selia e shoqerise eshte ne Lagjen "Xhevdet Nepravishta" Nr. 11 Lushnje. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj me zgjerimin e aktivitetit, me miratimin e ortakut te vetem.

#### NENI 4

Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me statutin e saj ne teritorin e Shqiperise dhe jashte saj . Shoqeria mund te krijojë filiale ne vende te tjera ne perputhje me legjislacionin e vendit perkates.


#### NENI 5

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar i perballon humbjet e saj deri ne kufirin e vleres te kapitalt te investuar në të.

### LIBRI I SHOQERISE

#### NENI 6

Per te preçizuar e per te saktësuar veprimtarine vetë ekonomike dhe mardheniet e shoqeria do te çele librin e vet, i cili do te quhet libri i shoqerise.





## KONFIDENCIALITETI

### NENI 7

Ortaku vete, dhe per personat e pranuar ne shoqeri, bie dakort qe te mos i ekspozoje asnje personi te jashtem informacionet qe do te disponoje shoqeria, kontratat qe ajo do te lidhe , si dhe planet dhe qellimet qe ajo ka per te ardhmen e saj.

### NENI 8

Te gjitha aktet dhe dokumentat e tjera qe nxirren nga shoqeria dhe te destinuara per te tretet, si letrat, faturat, lajmerimet dhe publikimet e ndryshme, duhet te tregojne lexueshem emerin e shoqerise dhe pas tij fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizar" ose inicialet "SHPK", kapitalin themeltar dhe emerin e administratorit.

### NENI 9

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:

Per zbatim :

- Kat. 1 - punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh
- Kat. 2 - a,c
- Kat. 3 - a,b ndertime civile e ekonomike
- Kat. 4/ a - ndertim rruge kat. V, IV
- Kat. 6/ a - ndertim vepra arti te vogla deri 6 metra
- Kat. 8/ a - ndertime diga, galeri, tunele, damba etj.
  - b - ndertim ujesejellesa e kanalizime.
  - c - ndertime vepra kullimi, ujitje toke e impiante vaditese.
  - g - punime mbrojtje dhe sistemi hidraulik.
- Kat. 9/ c - themele te vecanta.
  - d - perforcim themeli dhe punime speciale nentokesore.
  - e - izolim themeli nga ujrat.
- Kat.10/a - rindstrucone godina civile, ekonomike, veshje fasadash etj.
- Kat.14/d - mirembajta dhe zhvillimi I dekorit ne mjediset urbane
  - b - pastrimi I siperfaqes urbane.

## KOHEZGJATJA E SHOQERISE

### NENI 10

Shoqeria do te zhvilloje ajtivitetin e saj jo me pak se 10 vjet te mare si vit kalendarik, duke filluar nga data e regjistrimit ne regjistrin tregetar.

2



## KAPITALI THEMELTAR

### NENI 11

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke.  
Ky kapital eshte teresisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetem.  
Shoqeria mund te shtoje ose te pakesoje kapitalin e saj me miratimin e ortakut themelues.

### NENI 12

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve (neqoftese do te kete te tille ne te ardhmen), gjithashtu pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen edhe te treteve me miratimin e ortakut te vetem. Ato jane lirisht te transferueshme ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve si rruge trashegimie. Transferimet e pjeseve dhe kapitalit themeltar duhet te vertetohet me nje akt noterial.

## STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

### NENI 13

Shoqeria do ta konsideroje qendren e vet ne Lagjen "Xhevdet Nepravishta" Nr.11 Lushnjë, si shoqeri nene, e cila rast pas rasti do te hapet edhe me filjale te tjera, ose shoqeri te perbashketa ne te gjitha ato vende ku do te shikoje interes ne permbushjen e qellimit te saj, ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

### NENI 14

Organi me i larte i drejtimit te shoqerise eshte ortaku i vetem, organi vendimor.  
Shoqeria mund te administrohet nga:

- Nje administrator unik, i vetem aktualisht z.Agim Arapi, me drejtues teknik z.Dhimiter Koli Lako, me dtl.1952, banues ne lagja " Gafur Muco" Lushnje..
- Nje keshill administrativ.
- Dy administrator me nje firme te perbashket ose te vecante per secilin.

### NENI 15

Administratori ose administratoret ne qoftese do te kete, mund te jene ose jo ortake sipas percaktimit te ortakut te vetem.

Administratori shkarkohet me vendim te ortakut ose kur jep vete doreheqjen.

### NENI 16

Administratori unik dhe i autorizuar, i ka te gjitha kopetencat per te vepruar ne mardhenje me te trete ne emer te shoqerise dhe ne te gjitha rrethanat.

Ai ka te drejte te marre pjese ne shitje, ne blerje, ne procedurat e falimentimit, te hartoje kontrata te karaktereve te ndryshme, asikuracione, te tjeter soje pasuri te lujtshme dhe te palujtshme, te hape llogari rrjedhese prane Bankave Shqiptare dhe te huaja si dhe te depozitoje dhe te huaje para, te perfaqsoje shoqerine ne mardhenje me te tretet dhe ne organet gjyqesore dhe administrative etj.

## LIBRAT E SHOQERISE, BILANCI, SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI

### NENI 17

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec dokumentacionit kontabel ose librave te tjere edhe keto libra :

- Libri i ortakut ne te cilin shenohet emri i plote i tij dhe kuota e kapitalit themeltar.
- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te organit vndimor.
- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te organit administrativ.

### BILANCI

### NENI 18

Bilanci mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti, ku i pari do te jete perjashtimisht me 31 dhjetor te vitit 2001.

Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel i autorizuar nga ortakut i vetem miratohet nga ai, miratimi i ketyre dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 4 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

### DIVIDENTET

### NENI 19

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te egzistences se fitimeve, percaktohet pjesa qe i takon ortakut themelues ne formen e dividendit mbi fitimin.

Ky fitim perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondin e rezerve te domosdoshem te percaktuar nga ortakut, te fondeve te tjera qe shihen te nevojshme nga ana tjeter jane zbritur ose jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartuara nga vitet e meparshme.

## SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE.

### NENI 20

Shoqeria priset kur ka nje prishje te parakohshme per aresye te parashikuara ne ligj.



## NENI 21

Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi ortaku cakton nje ose disa likuidues, te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivit te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre. Ne fund te procesit te likuidimit ortaku vendos mbi biancin perfundimtar financiar dhe mbi mbyjllen e procesit te likudimit.

Mbas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates ( nese ka te tille ) likuiduesi ndan kapitalin per ortakun themelues.

## MARDHENIET PER PUNESIM

### NENI 22

Kriteret e pergjithshme te punesimit te personave te tjere, numerin e tyre, kufinjte e pageses dhe detyrat e secilit ne shoqeri percaktohet nga ortaku i vitem.

Punesimi i personave ne shoqeri kryhet mbi bazen e kontrates individuale te punes te hartuar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

### NENI 23

Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te sigurimeve shoqerore per te gjitha te punesuarit ne te, ndersa keta te fundit duhet te pranojne kete statut.

Te punesuarit pergjigjen simbas ligjit dhe sipas ketij statuti per mos zbatimin e detyrave dhe demeve qe ata i shkaktojne shoqerise.

### NENI 24

Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise, ose gjate periudhes se likuidimit, qe mund te lindin midis shoqerise dhe te treteve do te tentohet te zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert do ti paraqiten per zgjidhje gjykates kopetente shqiptare konforme legjislacionit shqiptar.

## DISPOZITA TE FUNDIT

### NENI 25

Shtimi i ortakeve:

Kur ortaku i vetem eshte dakort qe te behen shtesa kapitali me ane te personave te tjere, qe keta te fundit te konsiderohen ortake duhet te veprohet keshtu:

- Se pari merret vendim nga ortaku i vetem, ku shqyrtohet kerkesa e te interesuarit, behet pranimi dhe percaktohet kuota e kapitalit qe do te derdhe ortaku i ardhshem.

- Se dyti behet rregjistrimi ne librin e ortakut, ku shkruhet emri i plote i ortakut te ri dhe kuota ne kapitalin social.

- Veprimi i bashkimit te ortakut te ri duhet te behet me nje akt te noterial.

5  


NENI 26

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimeve te metejshme me ane amendamentesh sa here qe e shoh te arsyeshme ortaku themelues i kesaj shoqerie. Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre dhe procedure me te cilen behet vete nxjerrja e ketij statuti. Ndryshimet nuk prekin personalitetin juridik te shoqerise.

Ky statut eshte hartuar ne kater kopje shqip dhe pasi lexohet dhe gjendet sipas vullnetit te pales nenshkruhet prej tij rregullisht

ORTAKU I VETEM

AGIM ARRAPI

